



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më

protdate

Nr.

protnumber

RELACION
PËR
VENDIMIN
PËR

CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 88, PËR
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETARIN E BASHKISË HIMARË TË DATËS
4 GUSHT 2024

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN
NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 94, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendin e Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, i ka adresuar kërkesë Prefektit të Qarkut Himarë, për të vënë në dispozicion të KQZ, listën e plotë të objekteve që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, me qëllim përzgjedhjen dhe caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për ZAZ-në nr. 88.

Prefekti i Qarkut Himarë, me shkresën nr. 691/1 prot., datë 15.07.2024, ka paraqitur objektin i cili mund të shërbejë si Vend i Numërimit të Votave për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024. Ambienti i paraqitur është:

- Godina e fushës së Sportit, Rruga “Apelistrà”, salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Himarë.

Prefekti referon se ambienti është në kushte shumë të mira. Sipërfaqja është 178 m², brenda kriterëve ligjore. Sistemi i ndriçimit është i mjaftueshëm. Ambienti ka më shumë se një derë



komunikuese me ambientin e jashtëm, ambient të mjaftueshëm për të akomoduar grupet e numerimit, KZAZ-në dhe vëzhguesit.

Sipas shkresës së ardhur nga Prefekti i Qarkut Vlorë, nga konstatimet e tyre në këtë godinë, mjetet e mbrojtjes kundër zjarrit nuk ishin prezente, por do të sigurohen nga Bashkia Himarë në ditët në vijim. Gjithashtu, ambienti i propozuar nuk mundëson aksesin e personave me aftësi të kufizuara.

Nisur nga këto kushte, duke qenë se kemi vetëm një ambient të propozuar, i cili plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 93 dhe 94, pika 1, të Kodit Zgjedhor, për të caktuar vendndodhjen e VNV-së është Godina e fushës së Sportit, Rruga “Apelistra”, salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Himarë. Ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Erion META – Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:7.2024

Nr:

Ora:

VENDIM

PËR

CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 88,
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË
DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 93, pika 1, dhe nenit 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 88, Godina e Fushës së Sportit, Rruga “Apelistra”, salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak, Bashkia Himarë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 3 vjet
Punoit:
S.Bregasi _____
E.Dushallari _____
E.Meta _____
M.Çelmeta _____

Data: ... 7.2024 Nr:
Ora:



“Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të KZAZ-së nr. 88, për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”